



KUVENDI I KOMUNËS KLINË

Shërbimi për punë të Kuvendit

01 Nr. 06-86 /15

Klinë me 19. 01. 2015

EKSRAKT-PROCESVERBAL

Nga mbledhja e I-re e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur me datën 19. 01. 2015 në sallën e Kuvendit të Komunës me fillim në orën 10:00.

R e n d i i d i t ë s:

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesit të mbledhjes së kaluar,
3. Shqyrtimi i Projekt-Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe Lagjet urbane në territorin e Komunës së Klinës,
4. Shqyrtimi i inicimit të drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për vënie në diskutim publik të Projekt-Rregullores për lejet mjedisore Komunale,
5. Shqyrtimi i planit të punës së prokurimit për vitin 2015,
6. Shqyrtimi i planit të punës së KKSBB-se për vitin 2015,
7. Të ndryshme.

Në mbledhje ishin prezent:

1. Dr.Haxhi Ibishi.....Kryesues
2. Ramush Agushi.....anëtar
3. Fadil Gashi.....anëtar
4. Halil Desku.....anëtar
5. Pal Berisha.....anëtar
6. Ndue Shabanaj.....anëtar
7. Avni Gashi.....anëtar

Pjesëmarrës të tjerë në mbledhje ishin: Përfaqësues të OSBE-se, të KFOR-it, të zyrës Ligjore, të zyrës së informimit, drejtori i drejtorisë së Kadastrës z. Zeqir

Morina, nënkryetari i Komunës z. Enver Berisha, Dardan Bashota udhëheqës i sektorit të mbrojtjes së Mjedisit, mediet e tjerë.

Mbledhjen e hapi Dr. Haxhi bibishi i cili pasi i përshëndeti të gjithë të pranishmit i lexoi pikat e rendit të ditës të parapara për shqyrtim në këtë mbledhje.

Fadil Gashi tha së unë kamë një vërejtje shërbimit për punë të Kuvendit sepse nuk kamë qenë i njoftuar fare për këtë mbledhje.

Rendi i ditës u miratua unanimitisht nga anëtarët e KPF-se.

Pika e I-re: Arsyetimi i mungesave

Dr. Haxhi Ibishi tha së të gjithë anëtarët e KPF-se janë prezent në mbledhje.

Pika e II-te: Shqyrtimi dhe miratimi i procesit të mbledhjes së kaluar

Procesi i mbledhjes së kaluar u miratua unanimitisht nga anëtarët e KPF-se.

Pika e III-te: Shqyrtimi i Projekt-Rregullore për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës së Klinës

Dr. Haxhi Ibishi tha së kjo Projekt-Rregullore rregullon mënyrën e organizimit dhe bashkëpunimit mes komunës e fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane duke formuar këshillat lokale si trupa mbështetës të Komunës po për këtë ia jap fjalën përfaqësuesit të zyrës Ligjore të Komunës z. Ali Shala për të na dhenë sqarime .

Ali Shala: Tha së për këtë Projekt-Rregullore kemi debatuar edhe me parë ne Kuvend e kemi pasur në shqyrtim publik dhe janë kryer të gjitha procedurat por ka mbetur vetëm për shkak të implikimeve buxhetore, nëse dikush ka ndonjë vërejtje apo sugjerim mund të i paraqitni ato , ne si pushtet lokal duhet ta kemi një Rregullore të tillë.

Avni Gashi: Unë mendoj së duhet të precizohet kompensimi, kjo duhet të definohet qartë dhe është mirë ta kemi një parallogarit që të shihet së sa do të na kushtoi kjo. Kjo Rregullore është e një rëndësie të veçantë.

Halil Desku: Tha së kjo Rregullore është e mirë dhe i ndihmon shumë Komunës, shihet së duhet të dilet në terën që të zgjidhen udhëheqësit e këtyre këshillave, unë jam për miratimin e saj.

Fadil Gashi tha së këtë Projekt-Rregullore edhe me parë e kemi shqyrtuar në Kuvend por problemi është çështja e kompensimit të anëtarëve të këshillit, ne edhe atëherë kemi kërkuar nga drejtoria për Ekonomi e Financa që ta kemi një parallogarit lidhur me këtë, tek neni 7 thuhet së këshillat duhet të kenë përbërje etnike dhe gjinore gjegjësisht përfaqësimi gjinor të jetë 30% e kjo është vështirë të realizohet.

Ramush Agushi propozoi që për fillim të kompensohen vetëm kryetarët e bashkësive lokale .

KPF- Rekomandon që kjo projekt- Rregullore të bartet për shqyrtim dhe miratim ne Kuvend .

Pika e IV-te: Shqyrtimi i iniciativës së drejtorisë së Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit për vënie në diskutim publik të Projekt-Rregullores për LEJET MJEDISORE

Dardan Bashota udhëheqës i sektorit të mbrojtjes së mjedisit tha së e kemi parë si nevojë të domosdoshme hartimin e kësaj Rregulloreje me qëllim që procedurat administrative për pajisjen e qytetarëve me leje mjedisore Komunale të përputhen me legjislacion. Kjo Rregullore përcakton rregullat e procedurave për identifikimin, vlerësimin, raportimin e ndikimit të projekteve të caktuara në mjedis dhe zhvillimin e procedurave administrative gjatë procesit të marrjes së Vendimit për lëshimin e Lejeve Mjedisore Komunale.

KPF – rekomandon që iniciativa për vënie në diskutim publik të Projekt-Rregullores për dhënien e lejeve mjedisore Komunale të bartet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika e V-te:Shqyrtimi i planit të punës së prokurimit për vitin 2015

Dr. Haxhi Ibishi tha: pasi që zyrtari i zyrës së prokurimit mungon në këtë mbledhje propozoi që shqyrtimi i këtij plani të shtyhet për mbledhjen e ardhshme të KPF-se .

Fadil Gashi tha së unë propozoi që plani i punës së zyrës së prokurimit për vitin 2015 të bartet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend për arsye se humbet shumë kohë nëse shtyhet për mbledhjen e ardhshme.

Me këtë propozim u pajtuan të gjithë anëtarët e KPF-se.

KPF-rekomandon që plani i punës së zyrës së prokurimit të bartet për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

Pika e VI-te: Shqyrtimi i plani të punës së KKSB-se për vitin 2015

Enver Berisha-nënkryetar i Komunës: tha së ne nuk kemi mundur ta përgatisim Planin e punës së KKSB-se për këtë mbledhje por do të jetë e gatshme për mbledhjen e Kuvendit dhe do ta merrni së bashku me ftesat, ky plan është hartuar prej tetë pikave dhe dha sqarime rreth hartimit të këtij plani.

KPF- rekomandon që plani i punës së KKSB-se të bartet për shqyrtim dhe miratim ne Kuvend.


Pika e VII-te : Të ndryshme

Dr. Haxhi Ibishi th se nga grupi kuvendar 3-plus është kërkuar interpelancë nga drejtoresha e drejtorisë së Kulturës znj. Kristine Lazri, bazuar në çështjet e parashtruara të Komitetit për kulturë, Rini dhe Sport,

Ai po ashtu e lexoi edhe rekomandimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Mirëqenie sociale që nga Komuna kërkohen 100 mijë euro mjete financiare për furnizim me pajisje shëndetësore dhe renovimin e të gjitha objekteve aktuale në shëndetësinë e Komunës së Klinës.

Me kaq mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa përfundoi punën në orën 11:00.

Procesmbajtësi,
Besir Gashi



Kryesuesi i KPF-se,
Dr. Haxhi Ibishi

